




Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 2 dhe nenit 6 paragrafit 2.2 të Ligjit Nr. 05/L -042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe të nenit 40 të Rregullore Nr. 03- OB/2016 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Autoritetin Rregullator për Shërbime të Ujit, lidhur me Ndryshimin dhe Plotësim e të së njëjtës Rregullore Nr. 03-OB/2016, Drejtori Autoritetit, nxjerr,

Rregulloren Nr. 05-OB/2019 për Ndryshimin dhe Plotësim të Rregullore Nr. 03- OB/2016 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Autoritetin Rregullator për Shërbime të Ujit

Neni 1 Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim harmonizimin e vendeve të punës sipas strukturës organizative (organogrami), të miratuar për Autoritetin Rregullator për Shërbime të Ujit.

Neni 2

Secilën herë që përmendet "Kryesues" në Rregulloren bazike, kjo do të zëvendësohet me fjalën "Drejtor".

Neni 3

Titulli i nenit 10 dhe paragrafi 1 i këtij neni që përmendet "Zyrtar për Marrëdhënie me Publikun & Asistent Ekzekutiv të Drejtorit", riformulohet me tekstin si në vijim: "Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave (Asistent Ekzekutiv i Drejtorit)"

Neni 4

Titulli i nenit 14 paragrafi 1 riformulohet me tekstin si në vijim: "Drejtori i Departamentit për Çështje Ligjore dhe Licencim".

Neni 5

Titulli i nenit 16 dhe paragrafi 1 i këtij neni që përmendet "Zyrtar për Çështje Ligjore dhe Licencim", riformulohet me tekstin si në vijim: "Zyrtar Ligjor 2 (Licencimi)".

Neni 6

Titulli i nenit 19 paragrafi 1 i këtij neni që përmendet "Kryesues i Departamentit për Tarifa", riformulohet me tekstin si në vijim: "Drejtori i Departamentit për Tarifa".

Neni 7

Titulli i nenit 20 dhe paragrafi 1 i këtij neni që përmendet “Analist Financiar i Tarifave”, riformulohet me tekstin si në vijim: “Analist i Tarifave (Zyrtar Certifikues)”.

Neni 8

Titulli i nenit 21 dhe paragrafi 1 i këtij neni që përmendet “Analist për Asete dhe Investime Kapitale” riformulohet me tekstin si në vijim: “Analist për Asete dhe Investime Kapitale (Zyrtar Alternativ Certifikues)”.

Neni 9

Titulli i nenit 23 paragrafi 1 i këtij neni që përmendet “Kryesues i Departamentit për Raportim të Performancës”, riformulohet me tekstin si në vijim: “Drejtori i Departamentit për Raportim të Performancës”.

Neni 10

Titulli i nenit 25 dhe paragrafi 1 i këtij neni që përmendet “Analist i Performancës Financiare”, riformulohet me tekstin si në vijim: “Analist i Performancës Financiare (Zyrtar Alternativ i Shpenzimeve)”.

Neni 11

Titulli i nenit 26 dhe paragrafi 1 i këtij neni që përmendet “Analist i Performancës Teknike”, riformulohet me tekstin si në vijim: “Analist i Performancës Teknike (Zyrtar Alternativ i Pranimit)”.

Neni 12

Titulli i nenit 29 paragrafi 1 i këtij neni që përmendet “Kryesues i Departamentit për Administratë dhe Financa”, riformulohet me tekstin si në vijim: “Drejtori i Departamentit për Administratë dhe Financa (Zyrtar Kryesor Financiar)”.

Neni 13

Titulli i nenit 30 dhe paragrafi 1 i këtij nen, që përmendet “Zyrtar i Lartë i Personelit”, riformulohet me tekstin si në vijim: “Zyrtar i Personelit 2 (Zyrtar i Pranimit; Zyrtar për Regjistrin e Aseteve)”.

Neni 14

Titulli i nenit 31 dhe paragrafi 1 i këtij neni që përmendet “Zyrtar për Buxhet dhe Financa”, riformulohet me tekstin si në vijim: “Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa (Zyrtar i Shpenzimeve dhe të Hyrave)”.

Neni 15

Titulli i nenit 32 dhe paragrafi 1 i këtij neni që përmendet “Zyrtar Ndërlidhës për Prokurim dhe Administratë”, riformulohet me tekstin si në vijim: “Zyrtar Ndërlidhës për Prokurim dhe Administratë (Zyrtar për Urdhërblerja)”.

Neni 16

Titulli i nenit 33 dhe paragrafi 1 i këtij neni që përmendet “Zyrtar i Lartë për Menaxhimin e TI”, riformulohet me tekstin si në vijim: “Zyrtar i Lartë për Teknologji Informative (Zyrtar Zotues)”.

Neni 17

Titulli i nenit 34 dhe paragrafi 1 i këtij neni që përmendet që përmendet “Përkthyes Profesional”, riformulohet me tekstin si në vijim: “Zyrtar për Përkthime (Anglisht-Serbisht; Zyrtar Alternativ Zotues)”.

Neni 18

Titulli i nenit 35 dhe paragrafi 1 i këtij neni që përmendet “Zyrtar për Logjistikë/Shofer”, riformulohet me tekstin si në vijim: “Zyrtar për Logjistikë 1 (Zyrtar i Pasurisë; Zyrtar i të Hyrave & Vozitës)”.

Neni 19

Titulli i nenit 39 dhe paragrafi 1 i këtij neni që përmendet “Inspektor”, riformulohet me tekstin si në vijim: “Inspektor i Ujërave”.

Neni 20

Pozitat e nëpunësit civil

Pozitat e nëpunësit të Autoritetin Rregullator për Shërbime të Ujit janë ndryshuar dhe plotësuar me këtë rregullore, sipas shtojcës 1 të kësaj rregullore.

Neni 21

Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja Nr. 04-OB/2019 për Ndryshimin dhe Plotësim të Rregullores Nr. 03- OB/2016 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Autoritetin Rregullator për Shërbime të Ujit.

Neni 22

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Drejtori i Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit.

Datë 22.03. 2019
Prishtinë



